

M-CHAT-R

Ju lutem pergjigjuni pyetjeve te meposhtme mbi femijen tuaj. Ne pergjigjet tuaja kini parasysh si sillet femija zakonisht. Nese ju keni vene re qe femija juaj e manifeston sjelljen rralle (pak raste) por jo zakonisht (pjesen me te madhe te rasteve) atehere pergjigjuni pyetjes **jo**. Ju lutem futni ne rreth **po ose jo** per cdo pyetje. Shume falemnderit.

1. Ne qoftese i tregoni me gisht femijes nje objekt ne anen tjeter te dhomes a e drejton femija veshtrimin tek objekti? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, nese i tregoni femijes nje loder apo nje kafshe, duke perdorur gishtin tuaj tregues, a veshtron femija drejt lodres apo kafshes?)

2. A keni menduar ndonjehere qe femija juaj mund te jete i shurdhet? Po Jo

3. A luan femija juaj loje me imagjinate, sikur te ishte e vertete? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, te beje sikur pi dicka nga nje gote bosh, te beje sikur flet ne telefon ose sikur ushqen nje kukull apo nje loder kafshe prej pelushi?)

4. A i pelqen femijes tuaj te kacavirret (t'u ngjitet) gjerave/ objekteve? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, mobiljeve, paisjeve ne kendin e londrave, apo shkalleve?)

5. A ben femija juaj levizje te pazakonta te gishtave afer syve te tij/saj? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, a i perdredh femija gishtat e tij/saj afer syve?)

6. A tregon femija juaj me gisht per te kerkuar dicka apo per te kerkuar ndihme? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, te treguarit me gisht e nje biskote apo lodre qe ai/ajo nuk e arrin dot?)

7. A tregon femija juaj me gisht per t'ju treguar dicka interesante? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, t'ju tregoje me gisht nje aroplan ne qiell ose nje kamjon te madh ne rruge)

8. A tregon femija juaj interes per femije te tjere? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, a ia hedh veshtrimin femija juaj femijeve te tjere, a i buzeqesh apo i afrohet ai/ ajo atyre?)

9. A ju tregon juve femija gjera duke i sjelle/ mbajtur gjerat afer jush qe ju t'i shikoni - jo per t'ju kerkuar ndihme, por thjesht qe t'ua tregoje? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, t'ju tregoje nje lule, loder pelushi apo nje makine loder?)

10. A tregon/ pergjigjet femija kur ju i therrisni emrin? Po Jo
(**PER SHEMBULL**, a e drejton femija shikimin drejt jush, a flet ose belbezon, apo ndalon cfare eshte duke bere kur juve i therrisni emrin?)

Ju Lutem Vazhdoni ne Faqen Tjeter



M-CHAT-R

Ju lutem pergjigjuni pyetjeve te meposhtme mbi femijen tuaj. Ne pergjigjet tuaja kini parasysh si sillet femija zakonisht. Nese ju keni vene re qe femija juaj e manifeston sjelljen rralle (pak raste) por jo zakonisht (pjesen me te madhe te rasteve) atehere pergjigjuni pyetjes me **jo**. Ju lutem futni ne rreth **po ose jo** per cdo pyetje. Shume falemnderit.

- | | | |
|---|----|----|
| 11. Kur ju i buzeqeshni femijes, a ua kthen ai/ajo buzeqeshjen? | Po | Jo |
| 12. A shqetesohet femija juaj nga zhurma te perditshme?
(PER SHEMBULL , nga fshesa me korent apo muzike me volum te larte?) | Po | Jo |
| 13. A ecen femija juaj? | Po | Jo |
| 14. A ju shikon femija ne sy kur ju i flisni, kur luani me te apo kur e vishni? | Po | Jo |
| 15. A perpiqet femija juaj te kopjoje ate qe beni juve?
(PER SHEMBULL , te bej me dore mire u pafshim, te perplasi duart me gezim, ose te beje shaka me tinguj kur te njejten gje beni dhe juve) | Po | Jo |
| 16. Nese ju e ktheni koken per te pare dicka, a veshtron femija juaj perreth qe te shohi dhe ai/ajo ate qe po shikoni juve? | Po | Jo |
| 17. A perpiqet femija juaj qe t'ju terheqe vemendjen ne menyre qe ta veshtroni ate?
(PER SHEMBULL , a ju shikon femija ne pritje qe te lavderohet, apo a thote femija 'shif' ose 'me shiko') | Po | Jo |
| 18. A ju kupton femija kur ju i kerkoni atij/ asaj te beje dicka?
(PER SHEMBULL , ne qofte se ju nuk i tregoni me gisht, a e kupton femija shprehjen "vere librin ne karrige" ose "me sill batanijen") | Po | Jo |
| 19. Kur ndodh dicka e re e papritur, a e ndjek femija fytyren tuaj qe te shohi cfare ndjeni juve (si reagoni juve)?
(PER SHEMBULL , ne qofte se femija degjon nje zhurme te cuditshme, ose shikon nje loder te re a ia hedh femija veshtrimin fytyres tuaj?) | Po | Jo |
| 20. A i perlqejne femijes tuaj aktivitetet fizike?
(PER SHEMBULL , tundjet apo lekundjet ne prehrin/ gjunjet tuaj) | Po | Jo |